



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 194 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kaçanik.

### **Arsyetim**

PZAP-i, me datën 18.06.2012 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 17 Qershor 2012, dega e subjektit politik AAK, në Kaçanik, nëpërmjet përfaqësuesit të rinisë së AAK-së, Flakadan Abeja ka dërguar mesazh elektoral tek qytetarët e Kaçanikut. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 pika b) dhe c) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, si dhe neni 7.1 pika c) e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa foto të printuara të mesazheve elektronike si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj përfaqësuesit të saj të rinisë, dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri me datë 19.06.2012, deri në ora 15:00.

Sipas afatit të përcaktuar në shkresën Anr.194/2, PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se paraqitja e mesazheve telefonike bashkangjitur ankesës mund të manipulohen lehtë, personi në fjalë i identifikuar si dërguesi i mesazhit, nuk ka qenë pjesë e shtabit zgjedhor të Kandidatit Tahir Çaka, si

dhe mesazhet elektronike nuk mund të cilësohen si propagandë zgjedhore në periudhën e heshtjes zgjedhore, thuhet në përgjigjen në ankesë të subjektit politik AAK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se subjekti politik AAK, përmes përfaqësuesit të saj të rinisë Flakadan Abeja, ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore, për dërgimin e mesazheve elektorale tek qytetarët e Kaçanikut. PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë ngase në fotografitë e ofruara si provë për vërtetësinë e shkeljes së supozuar, nuk është specifikuar data se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, respektivisht thyerja e heshtjes zgjedhore, andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se në çfarë date ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe pasi që ankesës nuk i është bashkangjitur ndonjë provë bindëse që të argumentohet shkelja e pretenduar, PZAP-i, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 194/2012 më datën 21.06.2012.

